



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

Sekretariati i Shtetit për  
Çështje Ekonomike SECO



**PROGRAMI I  
BASHKËPUNIMIT  
ZVICERAN NË  
SHQIPËRI  
2026-2028**

**STRATEGJIA E  
POLITIKËS SË  
JASHTME  
2024-2027**



**STRATEGJIA E  
BASHKËPUNIMIT  
NDËRKOMBËTAR  
2025-2028**



**PROGRAMI I  
BASHKËPUNIMIT  
ZVICERAN NË  
SHQIPËRI  
2026-2028**

# Historiku

Tranzicioni i Shqipërisë drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut nisi në vitet 1990. Sot, ajo është vend me të ardhura të mesme të larta, anëtare e NATO-s dhe advokuese e vazhdueshme e rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Integrimi në Bashkimin Evropian është prioritet kombëtar kryesor për qytetarët shqiptarë, partitë politike dhe autoritetet. Kjo gjë siguron një kuadër shtrëngues për përafrimin me standardet dhe kërkesat e BE-së dhe shërben si forcë shtytëse për reformat.

Performanca ekonomike ka qenë e qëndrueshme dhe rritja është nxitur veçanërisht nga sektori i ndërtimit dhe sektori i turizmit në zhvillim. Politikat e matura fiskale kontribuuan në reduktimin e borxhit dhe në disinflacion. Gjithsesi, sfidat strukturore ekonomike si trysnia mbi mjedisin nga zhvillimi i shpejtë turistik, konkurrueshmëria dhe produktiviteti mesatar, ekonomia e gjerë informale dhe rrjedhat e paligjshme të parave vijojnë. Perceptimet rreth korrupsionit dhe besimi i kufizuar në sundimin e ligjit pengojnë investimet e huaja. PBB-ja për frymë vijon të jetë nën mesataren e BE-së.

*“Shqipëria ka bërë progres të qëndrueshëm institucional dhe ekonomik. Ky është një proces i vazhdueshëm përmirësimi. Zvicra e mbështet Shqipërinë në rrugëtimin e saj drejt përparimit të qeverisjes demokratike, përfshirjes sociale dhe shërbimeve publike, duke kontribuar për mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e rajonit.”*

Patricia Danzi, Drejtore e Përgjithshme e SDC-së



Ndonëse varfëria po ulet, ajo vazhdon të prekë thuajse 20% të popullsisë.

Migrimi i vazhdueshëm dhe shkalla e ulët e lindjeve kanë shkaktuar largimin e trurit, humbjen e kapitalit njerëzor, pakësimin e popullatës vendase (në rreth 2,4 milionë banorë) dhe rritjen e moshës mesatare. Kjo sjell sforcime për mbrojtjen sociale dhe financimin e pensioneve, si dhe mungesa të fuqisë punëtore, që plotësohen gjithnjë e më shumë nga punëtorë të huaj. Përgjithësisht, Shqipëria po përparon drejt integrimit në BE, por thellimi i reformave dhe siguri i përfitimeve të prekshme për qytetarët mbeten kritike.

Programi i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri

*“Teksa Shqipëria bën hapa para drejt integrimit evropian, Zvicra e mbështet me baza më të forta ekonomike, infrastrukturë të besueshme dhe klimë biznesi të nxitur nga inovacioni për rritjen e produktivitetit, tërheqjen e investimeve dhe krijimin e vendeve cilësore të punës.”*

Pietro Lazzeri, Drejtor për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik, SECO



kontribuon në qëllimin e politikës së jashtme të Zvicrës për të promovuar stabilitetin dhe integrimin evropian në Ballkanin Perëndimor. Në përputhje me Strategjinë e Politikës së Jashtme Ekonomike të Zvicrës, ai mbështet krijimin e kushteve të favorshme për investimet, zhvillimin e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës, duke forcuar kështu partneritetet ekonomike afatgjata midis dy vendeve. Zvicra vijon të jetë një donatore dypalëshe dhe partnere zhvillimi e përkushtuar për Shqipërinë, përmes programeve të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike SECO.



# Rezultatet dhe mësimet e nxjerra në periudhën 2022–2025

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Zviceran 2022–2025, Zvicra kontribuoi në disa reforma kyçe dhe forcimin e sistemeve.

## Qeverisje demokratike

Zvicra rriti performancën dhe ofrimin e shërbimeve në të 61 bashkitë, përmirësoi llogaridhënien dhe transparencën e këshillave bashkiakë dhe lehtësoi themelimin e një shoqate të unifikuar të bashkive. Shërbimet parlamentare, edukimi qytetar dhe proceset zgjedhore u fuqizuan për të përforcuar mbikëqyrjen, pjesëmarrjen dhe ligjvënien e bazuar në evidenca.

## Zhvillim ekonomik dhe punësim

U përmirësua menaxhimi financiar publik, duke përfshirë kontabilitetin në sektorin publik, menaxhimin e borxhit, risqet fiskale dhe mobilizimin e të ardhurave. Me mbështetjen zvicerane, Shqipëria hyri në SEPA - Zonën e Njësuar të Pagesave në Euro, përmes së cilës pritet të kursehen rreth 130 milionë Euro çdo vit vetëm nga tarifat e transaksioneve.

Zvicra kontribuoi në modernizimin e arsimit dhe formimit profesional (AFP) dhe prezantoi AFP-në duale, që tani mbulon 16 shkolla të cilat ofrojnë 21 kualifikime në bashkëpunim me 250 biznese. Ajo ndihmoi në përmirësimin e mjedisit të biznesit, qasjen në financim dhe tregje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe forcoi dialogun publik-privat për politikëbërje më të mirë ekonomike.

## Shërbime të besueshme të infrastrukturës urbane dhe ndryshimet klimatike

Zvicra kontribuoi për përmirësimin e politikave të sektorit të ujit dhe forcimin e performancës së ndërmarrjeve. Me qëllim rritjen e sigurisë energjetike, Zvicra mundësoi rishikimin e ligjeve për energjinë e rinovueshme dhe prezantoi praktikën e ankandeve transparente dhe konkurruese, duke sjellë investime të sektorit privat në impiantet diellore dhe të erës, që korrespondojnë me 10% të kapacitetit të energjisë në Shqipëri. Në sistem i ri i menaxhimit të energjisë solli përdorimin me eficiencë të energjisë nga bashkitë – një model që do të adoptohet në nivel kombëtar.

## Shëndetësia

Zvicra çoi përpara reformat e kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimet e urgjencës dhe kontribuoi në edukimin shëndetësor dhe parandalimin e sëmundjeve jo të transmetueshme. Modeli i kujdesit në shtëpi ofrohet tashmë nga 42% e qendrave shëndetësore dhe do të përhapet në të gjithë vendin. Reformat në mbrojtjen sociale bënë të mundur krijimin e Fondit Social Kombëtar dhe ofrimin e shërbimeve sociale nga bashkitë.

## Mësimet e nxjerra

- Qasja zvicerane e kombinimit të mbështetjes për reformat e harmonizuara me BE-në me fushat “e specializuara” (p.sh., kujdesi shëndetësor parësor) shton vlerë.
- Krijimi i partneriteteve ndërmjet institucioneve homologe shqiptare dhe zvicerane ka efekt afatgjatë në forcimin institucional.
- Pronësia kombëtare, konsolidimi dhe transferimi i modeleve të mbështetura nga Zvicra janë thelbësore për qëndrueshmërinë pas ndërprerjes graduale të SDC-së në vitin 2028.

# Angazhimi i Zvicrës – Fushat në fokus për 2026–2028

Zvicra mbështet rrugëtimin e Shqipërisë drejt integritimit në BE duke promovuar qeverisje demokratike, përfshirje sociale dhe rritje të qëndrueshme ekonomike. Programi riformësohet sipas tre fushave prioritare, duke pasqyruar konsolidimin e portofolit dhe sinergjive të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC me Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike, SECO.

## Qeverisja gjithëpërfshirëse

Zvicra synon garantimin e qëndrueshmërisë së qeverisjes demokratike dhe cilësisë së shërbimeve publike, duke përfshirë shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale. Veprimtaritë përqendrohen në konsolidimin dhe institucionalizimin e reformave, si dhe mbështetjen e qëndrueshmërisë financiare dhe përshkallëzimit të modeleve të zhvilluara.

Ndërhyrjet kryesore përfshijnë: forcimin e kontrolleve dhe balancave si dhe mbikëqyrjes parlamentare në nivel qendror

dhe vendor; përmirësimin e menaxhimit të financave publike bashkiake dhe ofrimin e shërbimeve të bazuara në performancë; promovimin e masave kundër korrupsionit dhe integritetit në përputhje me standardet e BE-së; konsolidimin e modeleve të kujdesit shëndetësor parësor, promovimit të shëndetit dhe kujdesit të emergjencave; si dhe mbrojtjen e grupeve të cënueshme. Fokus i veçantë do t'i jepet shfrytëzimit të përvojave dhe mësimave për ushqyer dialogun mbi politikat.

## **Zhvillim ekonomik dhe punësim**

Zvicra mbështet një kuadër të qëndrueshëm makroekonomik dhe një mjedis biznesi të orientuar drejt inovacionit për të rritur konkurrueshmërinë, produktivitetin, investimet dhe punësimin. Ndërhyrjet kryesore përfshijnë: forcimin e sektorit financiar, disiplinës fiskale dhe mbikëqyrjes; përmirësimin e klimës së biznesit, qasjes në financim dhe kapaciteteve të eksportit në prodhim, shërbime dhe bujqësi; mbështetjen e harmonizimit me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së (duke përfshirë standardet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes, auditimit të jashtëm dhe luftës kundër pastrimit të parave); dhe zhvillimin e aftësive që i përshtaten tregut të punës përmes AFP-së duale, të nxëniet në punë, digjitalizimit dhe shërbimeve të punësimit.


## **Shërbime të besueshme të infrastrukturës urbane dhe ndryshimet klimatike**

Zvicra synon përmirësimin e qasjes së barabartë të personave dhe bizneseve në shërbime infrastrukturore të qëndrueshme, të besueshme dhe të përballueshme, me fokus në ujësjellës dhe kanalizime, si dhe në tranzicionin e gjelbër të Shqipërisë drejt energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit të energjisë. Ndërhyrjet kryesore përfshijnë: forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe bashkiake për të planifikuar, ofruar dhe rregulluar shërbime të qëndrueshme të infrastrukturës dhe aksione të lidhura me klimën, si dhe mbështetjen e vazhdueshme për reformat në ujësjellës dhe kanalizime, efikasitetin e energjisë, energjinë e rinovueshme dhe aftësitë ripërtëritëse ndaj klimës.

## **Çështjet ndërsektoriale**

Gjatë gjithë programit do të ndiqen temat e mëposhtme: qeverisja e mirë (pjesëmarrja, llogaridhënia, decentralizimi, anti-korrupsioni, digjitalizimi), barazia gjinore dhe përfshirja sociale, migrimi, përballja me të kaluarën dhe mjedisi.

## Zhvillim ekonomik dhe punësim



## Qeverisja gjithëpërfshirëse



## Shërbime të besueshme infrastrukture dhe ndryshimet klimatike





# Qasja dhe partnerët

Qasja e Zvicrës përputhet me prioritetet e Shqipërisë për aderimin në BE tekrsa ruan fleksibilitetin dhe neutralitetin e një partneri të pavarur dypalësh. Ajo thekson pronësinë vendase përmes bashkëfinancimit dhe kur është e mundur, përdorimin e sistemeve dhe proceseve të vetë vendit dhe shfrytëzon partneritetet institucionale afatgjata ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe qendrave kompetente zvicerane (p.sh., zyrat federale të statistikave (FSO) dhe metrologjisë (METAS); IPI – Instituti Federal Zviceran i Pronësisë Intelektuale, EAWAG – Instituti Federal Zviceran i Shkencës dhe Teknologjisë Ujore; MeteoSwiss; shërbimet parlamentare zvicerane; universitetet dhe institutet e tjera të specializuara).


Dialogu për politikat do të intensifikohet gjatë përfundimit të planifikuar të veprimtarive të SDC-së deri në vitin 2028, ndërsa programi i SECO-s do të vijojë edhe pas vitit 2028. Zvicra bashkëpunon ngushtë me partnerët shumëpalësh (p.sh., Banka Botërore/IFC-ja, BERZH-i, FMN-ja, OKB-ja), partnerët dypalësh (Suedia dhe Gjermania) dhe Delegacionin e BE-së për të maksimizuar ndikimin dhe plotësimin.

## Programi i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri 2026–2028

### Buxheti i përgjithshëm tregues

58 milionë franga zvicerane


Detajimi sipas fushës në fokus



\* Informacioni mbi portofolin financiar është tregues. Ky informacion shërben thjesht si bazë për planet e ardhshme të shpenzimeve, që rishikohen çdo vit nga Këshilli Federal dhe Parlamenti Zviceran.

## Programi i Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri 2026–2028

Detajimi i buxhetit sipas agjencisë



SDC  
SECO





## Të dhënat e botuesit

Publikuar nga:

Departamenti Federal i Punëve të Jashtme FDFA

**Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim SDC**

3003 Bern – Zollikofen

[www.deza.admin.ch](http://www.deza.admin.ch)

Faqësja:

Mark Manion, Communication Arts

Fotografitë:

FDFA; GIZ Albania, Bledar Hasimi

Kontakti:

Seksioni i Evropës Juglindore

+41 58 467 87 78

[deza.osteuropa@eda.admin.ch](mailto:deza.osteuropa@eda.admin.ch)

Ambasada e Zvicrës

Rruga 'Ibrahim Rugova' 3/1

1019 Tiranë

Shqipëri

Bern, 2026

© FDFA/SDC

